Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit per Energji
Regulatorni Ured za Energiju
www.ero-ks.org

Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Prishtina 20/09/2006
ERO Code: D_13_2006

Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Mandatin ligjor sipas Nenit 45 deri në 48 të Ligjit Nr. 2004/9 "Mbi Rregullatorin e Energjisë";
2. Punimin Pozicionues lidhur me "Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit - WACC" të publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së më 28 Korrik 2006;
3. Komentet e pranuara lidhur me këtë Punim Pozicionues dhe përgjigjet në këto komente të përgatitura nga konsulentët për ZRRE-në, të gjitha të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së;

Ka vendosur të miratojë Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (MPKK - WACC) që të aplikohet nën Shqyrtimin e Parë të Çmimeve:

Kapitulli 1: Baza Ligjore

1. Bazuar në mandatin ligjor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) lidhur me Rregullimin e Çmimeve siç është caktuara në Nenet 45 deri në 48 të Ligjit Nr. 2004 / 9 mbi Rregullatorin e Energjisë, Rregulli mbi Principet e Kalkulimit të Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike i nxjerrë nga ZRRE dhe Metodologjia e Tarifave e nxjerrë nga ZRRE, ZRRE_ja do të përcaktojë një WACC që të shfrytëzohet për të caktuar të ardhurat e lejuara të mbuluara nga Tarifat e rregulluara të të licencuarve.
2. Shqyrtimi i Parë i vazhdueshëm i Çmimeve do të caktojë të ardhurat e lejuara për të licencuarit dhe, më pas do të qojë tek aprovimi i tarifave të rregulluara për të hyrë në fuqi nga 1 Janari 2007.
3. Si pjesë e Shqyrtimit të Parë të Çmimeve, ZRRE-së i kërkohet të caktojë një vlerë të përshtatshme për WACC punim pozicionues lidhur me vlerën e propozuar të WACC, të përgatitur nga konsulentët për ZRRE-në, në faqen e vet elektronike më 28 Korrik 2006 për komente.
4. Komente të gjëra janë dorëzuar nga KEK Sh.A., dhe janë shqyrtuar nga ZRRE-ja dhe konsulentët e vet. Këto komente dhe përgjigjet e konsulentëve të ZRRE-së janë publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së.
5. ZRRE-ja i çmon komentet e pranuara nga KEK Sh.A. Sidoqoftë, ZRRE_ja nuk konsideron se këto e arsyetojnë atë që të devijon nga propozimet që përfshihen në punimin origjinal pozicionues. Veçanërisht, ZRRE-ja thekson se në komente nuk është propozuar ndonjë vlerë alternative për WACC që të shfrytëzohet për të caktuar të ardhurat e lejuara.

Kapitulli 2: Vendimi

Vendimi i ZRRE-së është të miratojë vlerën e WACC, për që të dyja, KEK Sh.A dhe KOSTT-in në mes të rangut të rekomanduar nga konsulentët e vet, e që është:

10.8% në baza reale para tatimit.

Kapitulli 3: Zbatueshmëria

Ky Vendim do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

Aprovuar nga Bordi i ZRRE-së: Prishtinë, 20 Shtator 2006

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së:

Dr. Nick Frydas

Anëtarët e Bordit:

Znj. Merita Kostari

Z. Naim Bejtullahu

Znj. Theranda Beqiri

Dr. Nysret Avdiu